

L I G J
Nr.8150, datë 11.9.1996

**PËR ADERIMIN E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË NË KONVENTËN “PËR UNIFIKIMIN
E DISA RREGULLAVE TË TRANSPORTIT AJROR NDËRKOMBËTAR”, NËNSHKRUAR
NË VARSHAVË MË 12.10.1929**

Në mbështetje të nenit 16 të ligjit nr.7491, datë 29.4.1991 “Për dispozitat kryesore kushtetuese”, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

**KUVENDI POPULLOR
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË**

V E N D O S I:

Neni 1

Republika e Shqipërisë aderon në konventën “Për unifikimin e disa rregullave të Transportit Ajror Ndërkombëtar” nënshkruar në Varshavë më 12.10.1929

Neni 2

Ky ligj hyn në fuqi menjëherë.

Shpallur me dekretin nr.1613, datë 19.9.1996 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Sali Berisha